

Partnerët kryesorë në kontekstin e planifikimit në mbarë Kosovën

- » Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- » Planifikimi (DPH dhe IPH) – pala homologe kryesore në nivelin qendror
- » Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – partner për çështjet e qeverisjes lokale
- » Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit – partner për çështjet e transportit dhe lëvizshmërisë
- » Asociacioni i Komunave të Kosovës/Kolegiurni për Planifikimin Hapësinor – platformë për promovimin e politikave urbane, këmbim të informative dhe përvojave
- » Zyra për Qeverisje të Mirë në Kryeministri – partner për qeverisje të mirë, të drejta të barabarta dhe çështje gjinore
- » Organizatat e shoqërisë civile, OJQ-të, - palët me interes në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të projekteve
- » Agjencitë e OKB-së në kuadër të UNKTT, BE dhe OSBE – partnerë për veprimtari të përbashkëta ose programe
- » Trashëgimia Kulturore pa Kufi (CHWB) dhe Plani i Veprimit Lokal Mjedisor (LEAP) – programe të financuara nga Sida
- » FES – Friedrich Ebert Stiftung, partner në promovimin e debeteve publike
- » Divizioni Rajonal për Bashkëpunim Teknik i UN-HABITAT-it, Zyra në Varshavë për Evropën Qendrore dhe Lindore
- » Universiteti i Prishtinës, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe zyrat komunale të saj
- » UNMIK – Misioni i OKB-së në Kosovë – partner për Kornizën e Integruar për Bashkëpunim Strategjik

UN-HABITAT-i në Kosovë dhe Evropë Jug-Lindore

Gjatë gjithë kohës së pranisë së tij në Kosovë dhe rajonin e gjerë të EJL prej vitit 1999, UN-HABITAT-i e ka promovuar qeverisjen e mirë, të drejtën e shfrytëzimit, pjesëmarrjen e barabartë të meshkujve dhe femrave në zhvillimin e vendbanimeve njerëzore të qëndrueshme dhe planifikimin hapësinor përfshirës. Intervenimet fillestare të UN-HABITAT-it në Kosovë ishin të fokusuara në krijimin e institucioneve për t'u marrë me çështjet pronësore – Drejtoria për çështje Banesore dhe Pronësore dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës – dhe për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin efikas të qeverive lokale nëpërmjet Programit për Mbështetjen e Komunave dhe LoGo (Programi për Qeverisje Lokale). Programet pasardhëse: Programi për Planifikimin dhe Menaxhimin Urban (UPMP, 2001-2003), Programi për Qeverisje dhe Planifikimin e Zhvillimit (GDPP, 2003-2006), Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal 1 (MuSPP, 2005-2007) dhe Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal 2 (MuSPP, 2008-2011) kanë ndihmuar në zhvillimin, ankorimin dhe institucionalizimin e një sistemi të ri të planifikimit dhe në foramin e kapaciteteve të profesionistëve që merren me planifikimin hapësinor dhe urban në nivelin qendror dhe lokal. Ndërtimi i kapaciteteve për planifikim përfshirës është një parakusht për përafim në Bashkimin Evropian. UN-HABITAT-i ka bashkëpunuar me një numër të ndryshëm të vendeve në rajonin e Evropës Jug-lindore për këshillime lidhur me politikën e urbanizimit dhe të bashkëpunimit teknik. Për përkrahjen e vendeve të EJL në avancimin e reformave në fushat e zhvillimit të banimit dhe atij urban dhe për ta ndihmuar procesin e integritimit në BE, UN-HABITAT-i në bashkëpunim me Paktin e Stabilitetit dhe në konsultim të ngushtë me qeveritë e Ballkanit Perëndimor, e ka krijuar një Program Rajonal për Foramin e Kapaciteteve për Zhvillimin e Banimit dhe atij Urban. Ky program realizohet nga Zyra e UNHABITAT-it për Evropën Qendrore dhe Lindore, me seli në Varshavë.

Mandati i UN-HABITAT-it

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore, UN-HABITAT, është Agjencia e Kombeve të Bashkuara e mandatuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së për promovimin e qyteteve dhe fshatrave të qëndrueshme nga aspekti shoqëror dhe mjedisor me qëllim të ofrimit të strehimit adekuat për të gjithë. Në frymën e urbanizimit global të hovshëm, vizioni strategjik i UN-HABITAT-it ofron rrugën drejt arritjes së kësaj agjende të spektrit të përgjithshëm, duke spikatur mjetet për realizimin e programeve dhe projekteve në raport të duhur dhe praktik me prioritetet globale dhe Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit.

Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbutja e varfërisë kërkojnë integrimin e objektivave ekonomike, shoqërore dhe politike në një kornizë koherente të përgjithshme. Si një pjesë e Fushatës Globale të UN-HABITAT-it për Qeverisjen Urbane, përfshirja e shoqërisë civile në procesin e vendim-marrjes dhe ndërtimit të konsensusit për çështjet e zhvillimit lokal është një prej parimeve kryesore të Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal.

UN-HABITAT Kosovë, Nazim Gafuri Street, 33, Kat i fundit, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 517 835 Fax: +381 38 517 836 | info@unhabitat-kosovo.org
Website: www.unhabitat-kosovo.org www.unhabitat.org

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



Bashkë Bëjmë Qytete më të Mira

Faza 2, 2008-2011

UNHABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga
Sida

Përse planifikimi urban dhe hapësinor?

Dhjetë vitet e fundit kanë qenë një periudhë e kthesave në historinë e Kosovës dhe popullit të saj, si në pikëpamjen politike ashtu edhe në atë shoqërore. Ndryshimet e mëdha politike dhe ekonomike, pas konfliktit ushtarak, kanë rezultuar në migrimin e popullatës nga zonat rurale drejt qyteteve të Kosovës.

Megjithatë, qytetet nuk janë të përgatitura për këto fluks të popullatës. Edhe pse disa prej qyteteve më të mëdha tashmë i kanë miratuar planet zhvillimorë komunale dhe urbane të tyre, realizimi i këtyre planeve nuk është i lehtë. Kjo sjell deri te zhvillimi i kaotik, si në aspektin e zhvillimeve banesore dhe komerciale, po ashtu, edhe përkitazi me infrastrukturën fizike përkatëse.

Sikur të gjitha demokracitë e reja, Kosova është ballafaquar me një numër të problemeve dhe sfida. Shumë prej tyre kanë të bëjnë me detyrën e ndërlikueshëm të kaluarës me të tanishmen, me shikimin drejt ardhmërisë evropiane. Në kontekstin e planifikimit hapësinor dhe urban, sfida kryesore është mënyra se si të ndërlihet e kaluara e Kosovës e dominuar me qytete të vogla dhe të mesme me zhvillimin e hovshëm të qendrave urbane duke e ndjekur trendin global të urbanizimit.

Për çfarë është ky Program?

Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), në Fazën 2 të planit 3 vjeçar të punës së tij, vazhdon t'i përkrah komunitetin në konsolidimin e planifikimit urban dhe hapësinor nëpërmjet të një procesi pjesëmarrës dhe me barazi gjinore. Realizimi i projekteve për investime kapitale, që dalin nga ky proces i planifikimit, do të sjellë kushte më të mira për jetë dhe një mjedis urban më tërheqës. Me metodologjinë e të mësuarit duke punuar dhe me anë të ndihmës gjatë punës, ky program synon forcimin e kapaciteteve të homologëve dhe palëve të interesuara për qasjen e planifikimit strategjik. Po ashtu, programi synon shtimin dhe promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar.

Motoja e MuSPP-së është "Së bashku krijojmë qytete më të mira", e cila do të thotë se planifikimi i zhvillimit lokal nuk i takon vetëm profesionistëve, por edhe qytetarëve të përfaqësuar nga grupe të ndryshme shoqërore dhe të moshave, burra e gra, djem e vajza. Faza e tanishme e MuSPP-së vazhdon mbi bazën e punës së mëshërme të programit, që ishte e fokusuar në ndihmën për gjashtë qytete dytësore për hartimin e planeve zhvillimorë komunale dhe urbane. Këto plane duhej të ishin strategjike, të orientuara në veprime dhe të përgatitura në mënyrë përfshirëse. Aktualisht, shumica e këtyre komunave janë në proces të zbatimit të këtyre planeve nëpërmjet planeve të nivelit më të ulët, si planet rregulluese dhe të investimeve kapitale. Në shumë raste, angazhimi i fondeve private apo të donatorëve do ta përcaktojë suksesin e këtyre veprimtarive.

Në fazën e tanishme, MuSPP-ja bashkëpunon me 5 komuna më të mëdha me qendra urbane të fuqishme – Ferizaj, Gjiilan, Mitrovica, Peja, Prizreni, por edhe me 3 komuna më të vogla të formuara rishtazi – Juniku, Hani i Elezit dhe Mamusha, të cilat kanë karakter rural.

Konsolidimi i planifikimit në ciklet

Planifikimi nuk është një punë e njëhershme. Planet komunale, urbane dhe rregulluese duhet të zhvillohen përpara ndryshimeve të mjedisit urban dhe të krijojnë kushte për investime të reja, duke e mbajtur kontrollin mbi projektet zhvillimorë. Prandaj, konsolidimi i praktikës së planifikimit dhe revidimi i ciklit të këtyre planeve janë të domosdoshme nëse dëshirojmë që planifikimi urban dhe hapësinor ta luajë rolin e duhur të tyre. Për ta bërë të suksesshëm këtë proces të planifikimit kërkohet struktura efiçente për planifikim në nivelin qendror dhe atë lokal, personeli i kualifikuar si dhe praktika planifikimi dhe mekanizma zbatimi të ndërtuara mirë.

Prandaj, ndihma gjatë punës për komunitetin partnerë ka për synim ndërtimin e kapaciteteve për kryerjen dhe monitorimin e veprimtarive të planifikimit hapësinor dhe urban, si dhe përgatitjen e terrenit për realizimin efiçent të tyre.

Zhvillimi dhe realizimi i projekteve strategjike për investime kapitale

Qëllimi i planeve komunale dhe urbane është që të përcaktohen prioritetet zhvillimorë dhe të krijojnë kushtet për investime të reja. Njësoj sikur procesi i planifikimit, zhvillimi i projekteve kapitale duhet të marrë parasysh prioritetet rinj, apo vendosja e elementeve të duhura nëpër rrugë – koshat për mbeturina, ulëset ose ndriçimi përbëjnë një dallim të madh në mënyrën se si njerëzit i perceptojnë këto hapësira publike.

Ky program do t'ju ndihmojë komunave partnere që t'i zhvillojnë dhe financojnë këto projekte.



PEJE



JUNIKU



MAMUSHA



PRIZREN



MITROVICA



FERIZAJ



HANI I ELEZIT



GJILAN

PRISHTINE

Forcimi i kapaciteteve të institucioneve qendrore për t'i ndihmuar komunat në planifikim

Shumë prej komunave më të vogla kanë burime të kufizuara financiare dhe njerëzore për ta bërë vetë planifikimin. Ligji për Planifikimin Hapësinor i jep një rol të rëndësishëm Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për t'i përkrahur komunitetin në zhvillimin e planeve komunale dhe urbane.

Shfrytëzimi i Kolegjit për Planifikim Hapësinor të Asociacionit të Komunave në Kosovë si një organ për këmbim të informatare do të ndihmojë në forcimin e ndërveprimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. MuSPP-ja do t'i përkrah këto veprimtari dhe do t'u ndihmojë planerëve kosovarë në vënien e kontakteve me homologët e tyre në vendet tjera. Ky program, po ashtu, do të krijojë një platformë për të mësuar nga kolegët.

Përmirësimi i kushteve për jetë në Vendbanimet Joformale

Vendbanimet Joformale dhe ndërtimet ilegale janë ndër problemet kryesore të zhvillimit urban me të cilat ballafaqohet Kosova. Disa prej tyre janë duke u integruar gradualisht në zonat urbane, të pajisura me shërbime dhe infrastrukturë, derisa të tjerat janë ilegale dhe joformale. Të drejtat pronësore dhe drejta e shfrytëzimit e banorëve të Vendbanimeve Joformale është shndërruar në një element të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian për Kosovën në rrugën e saj drejt përafrimit të mëtejshëm me Bashkimin Evropian. Ky program do të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me komunitetin partnerë për adresimin e çështjes së Vendbanimeve Joformale.

Shfrytëzimi i mësimave të mësuar dhe të mësuarit nga kolegët si mjete për ndërtimin e kapaciteteve

Angazhimi i MuSPP-së gjatë fazës së parë të programit, i ka mundësuar personelit komunal të gjashtë komunave sekondare që të përfitojnë përvoja praktike të planifikimit si dhe të zhvillojnë metoda efektive për përfshirjen e zyrtarëve të zgjedhur, profesionistëve ose pjesëtarëve të shoqërisë civile në procesin e planifikimit. Ky program po i replikon këto metoda në punën e tij me komunitetin partnerë më të vogla si dhe në aktivitetet që kanë për synim zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave.

Cilat janë sferat tjera të veprimtarive të MuSPP-së?

Megjithë që formalisht fokusi i veçantë i MuSPP-së është në zhvillimin dhe realizimin e planeve komunale dhe urbane, kjo në praktikë do të thotë integrimi i një spektri më të gjerë të çështjeve të ndërlikueshme. Këtu përfshihen, p.sh. vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut nga katastrofat; transporti dhe lëvizshmëria, përmirësimi i sigurisë, qasja dhe cilësia estetike e hapësirave publike, ruajtja e trashëgimisë historike dhe natyrore nëpërmjet kontrollimit të zhvillimit dhe planifikimit rregullues. Në gjithë këtë punë, qytetarët, duke i përfshirë grupet me nevojë të posaçme, janë në rendin e parë të këtyre veprimtarive.

Si punojmë ne?

Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal fokusohet në bashkëpunimin dhe ndihmën gjatë punës për çdo ditë me personelin e komunës. Ky program funksionon nëpërmjet zyrate të tij në terren që ndodhen në Ferizaj, Gjiilan, Pejë, Mitrovicë dhe Prizren. Ekipeve komunale të MuSPP-së përbëhen nga planerët ndërkombëtarë dhe kosovarë, të cilët u ndihmojnë komunave në veprimtaritë e planifikimit dhe në zhvillimin e projekteve për investime kapitale në mënyrë pjesëmarrëse, përfshirëse dhe të orientuar në punë. Përkrahjen për ekipeve komunale të MuSPP-së për procesin e planifikimit, pjesëmarrjen publike, aspektin gjinor, çështjet ligjore dhe informimin e komunikimin e siguron zyra në Prishtinë.

MuSPP-ja bashkëpunon ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe me grupet qytetare joformale për forcimin e kapaciteteve të tyre për pjesëmarrje në proceset e planifikimit urban dhe hapësinor si dhe në dizajnimin, realizimin dhe monitorimin e projekteve.